ClickFinance

Specialist/e i/e Pajtueshmërisë

Rreth ClickFinance SHA

ClickFinance SHA është Institucion Financiar Jo Bankar, që po ndërton një platformë moderne për financime dhe zgjidhje digjitale për bizneset dhe individët në Kosovë.
Në vazhdën e themelimit jemi në kërkim të stafit profesional që ta mundesojë avansimin e institucionit drejt tregut financiar. Zyrtari/ja i/e Pajtueshmërisë do të ketë rol kyç në ndërtimin e proceseve të brendshme dhe funksionimin e përditshëm të kompanisë.

Përgjegjësitë Kryesore

- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të brendshme për përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore të Kosovës dhe ligjet në fuqi.
- Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave KYC (Know Your Customer) dhe AML (Anti–Money Laundering).
- Monitorimi i transaksioneve të dyshimta dhe raportimi pranë autoriteteve përkatëse.
- Këshillimi i menaxhmentit për çështje ligjore dhe rregullative që ndikojnë në operacionet e kompanisë.
- Hartimi, rishikimi dhe menaxhimi i kontratave me partnerë, klientë dhe furnitorë.
- Sigurimi i përputhjes së plotë të proceseve të brendshme me kornizën ligjore dhe standardet e licencimit financiar.
- Mbajtja e evidencave ligjore dhe përgatitja e raporteve periodike për menaxhmentin dhe autoritetet rregullative.

Kualifikimet e Kërkuara

- Diplomë universitare në Juridik, ose fusha të ngjashme.
- Minimum 3 vite përvojë në sektorin bankar, financiar ose në institucione të ngjashme.
- Njohje shumë e mirë e legjislacionit financiar, rregulloreve të BQK-së dhe praktikave ndërkombëtare AML.
- Aftësi të mira analitike dhe kujdes i lartë ndaj detajeve.
- Integritet profesional, konfidencialitet dhe aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur.
- Njohja e gjuhës angleze është avantazh.

Çfarë ofron ClickFinance SHA

Mundësi për të ndërtuar karrierë në një institucion të sapolicencuar. Një pervojë e re profesionale në një ambient me fokus në inovacion dhe transparencë. Pagë konkurruese dhe kushte pune të qëndrueshme.

Konkursi është i hapur deri me datën 23.03.2026.

Apliko në: karriera@clickfinance-rks.com tel: +383 48 100 112